

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

03.05.2023
Ora, 12:17

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesave për akreditim vëzhguesish”, për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Znj. I. Osmanaj, Z. E. Meta,
Znj. P. Doçaj, Znj. E. Allushi,
Znj.V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF (F. Nuri).**
- **Të tjerë:** **KRIIK, OSBE/ODIHR, Qëndresa Qytetare (Dh. Zguro).**

Z. I. Celibashi: Mirdita! Në seancën e sotme kemi në rend ditë këto çështje: projektvendimin për shqyrtimin e disa kërkesave për akreditim të vëzhguesve për zgjedhjet e datës 14 maj; urdhri për zbatimin e disa rregullave për personat e pranishëm në territorin e objekteve zgjedhore ku janë vendosur qendrat e votimit; projektvendimin që lidhet me vlerësimin e raportimit të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 14 prill - 20 prill; projektvendimin për heqjen e materialeve propagandistike, të cilat nuk janë vendosur në përputhje me parashikimet e ligjit, materialet propagandistike materiale, pika e 7 ka të bëjë me vlerësimin e raportit të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën deri më 2

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

maj të vitit 2023; shqyrtimet administrative të denoncimeve numër 281 të KRIIK-ut, numër 299, 239, 240,241, 242 po të KRIIK-ut; kemi shqyrtimin e denoncimit numër 210, po të KRIIK-ut, kemi shqyrtimin e denoncimit numër 283, të deputetes Albana Vokshi, si dhe denoncimin numër 256 të bërë po nga deputetja Albana Vokshi, po kështu edhe 252, 253 dhe 254; kemi të mbartura: shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për pasqyrimin e fushatës zgjedhore nga operatorët televizivë për periudhën 14-22 prill 2023; është më pas në rend dite shqyrtimi i denoncimit numër 387 të Partisë Socialiste, ndaj subjektit zgjedhor Bashkë Fitojmë, kemi shqyrtimin administrativ të denoncimit numër 337 të organizatës Qëndresa Qytetare ndaj Këshillit të Ministrave, gjithashtu, në rend dite janë shtuar, në fakt, janë dy çështje: projektvendim për plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë së Divjakës dhe projektvendimi për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste, zotit Frrok Gjini për Qarkun e Shkodrës. Fillojmë me çështjet sipas radhës në rendin e ditës, shqyrtimi i kërkesave të disa operatorëve radiotevizivë ose dhe organizatave vendase dhe të huaja për akreditimin.

Znj. E. Allushi: Agjencia Telegrafike Shqiptare i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si edhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 10 gazetarëve dhe operatorëve; Shoqëria “Panorama Grup” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 17 gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre; televizioni “Vizion Plus” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditim të 74 gazetarëve dhe operatorëve, televizioni “Ewro News” i ka paraqitur kërkesën Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për akreditimin e 82 gazetarëve dhe operatorëve; televizioni “2CNN”, i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 73 gazetarëve dhe

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

operatorëve, qendra “Birn Albania” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 8 gazetarëve dhe zonat e vëzhgimit të tyre’ “Mat Televizion” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 7 gazetarëve dhe operatorëve media online “Saranda Web i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 1 gazetari dhe media online “Bulqiza Ime” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 15 gazetarëve. A mund të vazhdoj edhe për kërkesat e tjera?

Z. I. Celibashi: Po.

Znj. E. Allushi: Agjencia e lajmeve “BTA”, i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e një gazetari; Agjencia “Anadolu” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 2 gazetarëve, ndërkohë qendra “Comuniti Reports Albania” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për 9 vëzhgues afatshkurtër, qendra “Qytetarët në Demokraci” për 202 vëzhguesve afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Të gjitha këto kërkesa plotësojnë afatet kohore, kanë dokumentacionin e plotë dhe respektojnë bazuar në Kodin Zgjedhor.

Z. I. Celibashi: Atëherë, i miratojmë kërkesat për akreditim të vëzhguesve të Agjencisë Telegrafike Shqiptare, Shoqërisë “Panorama Grup”, Televizioni “Vizion Plus”, Televizioni “Euronews”, Televizioni “A2 CNN” Qendra “ Birn Albania”, “Mat Televizion” dhe mediat online “Bulqiza Ime” dhe “Saranda WEB”, agjencia e

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

lajmeve “BTA”, agjencia “Anadolu”, qendra “Comuniti Reports Albania”, qendra “Qytetarët në Demokraci”.

Vendimi nr. 426, 427, 428

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

**03.05.2023
Ora, 12:23**

RENDI I DITËS

Urdhër “Mbi zbatimin e disa rregullave për personat e pranishëm në territorin e objekteve zgjedhore ku janë vendosur qendrat e votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Znj. I Osmanaj, Z. E. Meta,
Znj. V. Ballgjini, Znj. E. Allushi**
- **Parti Politike:** **BF (F. Nuri)**
- **Të tjerë:** **OSBE/ODIHR, Qëndresa Qytetare**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me çështjen tjetër të rendit të ditës, urdhrin “ Për zbatimin e disa rregullave për personat e pranishëm në territorin e objekteve zgjedhore ku janë vendosur qendrat e votimit”.

Z. E. Meta: Neni 90 pika 1 shkronja “dh” parashikon si kompetencë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet subjektet apo personat e ngarkuar me detyrime sipas Kodit Zgjedhor. Nenet 109 dhe 110 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë rregullat për prezencën në ambientet e brendshme dhe të jashtme të qendrës së votimit. Në nenin 109, pika 6 përcaktohet se në mjediset jashtë qendrës së votimit


*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj dhe në korridoret e brendshme të ndërtesës nuk lejohet; prania ose grumbullimi i personave përveç zgjedhësve që presin në radhë për të votuar. Vendimi numër 11, datë 25.03.2021, i Komisionit Rregullator “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të komisionit të Qendrës së Votimit” i ndryshuar dhe vendimit nr. 12 të Komisionit Rregullator për miratimin e rregullave të veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve, parashikon rregulla dhe procedura për moslejimin në ambientet e qendrës së votimit, përveç administratës zgjedhore zgjedhësit që është në radhë për të votuar dhe personave të autorizuar sipas përcaktimeve ligjore. Në nenin 17, të vendimit 11 përcaktohet se komisioni i Qendrës së Votimit merr vendim për pezullimin e votimit dhe kërkimin e ndihmës së Policisë së Shtetit për rivendosjen e rendit në Qendrën e Votimit. Neni 37, pika 5 i po këtij vendimi parashikon se prezenca e personave të tjerë jashtë parashikimeve të kësaj dispozite në rrethinat e Qendrës së Votimit, në një rreze prej 150 metrash, është shkak për pezullimin e procesit dhe për të kërkuar ndërhyrjen e Policisë së Shtetit për të rivendosur rendin. Nga përvoja e zgjedhjeve pararendëse ka rezultuar se ka pasur denoncime të shumta për prezencën në ambientet e jashtme të zgjedhësve në godinat ku ndodhen më shumë se një qendër votimi. Shqetësimet e subjekteve të vëzhguesve ka konsistuar në mos marrjen e vendimit nga ana e Komisionit të Qendrave të Votimit apo nga KZAZ-ja dhe rrjedhimisht ka sjellë mungesën apo vonesën e ndërhyrjes së Policisë së Shtetit për të rivendosur rendin. Ky urdhër parashikon procedurën që duhet të ndjekë në rastet kur një anëtar i Qendrës së Votimit konstaton prezencën e personave të paautorizuar në ambientet e brendshme dhe të jashtme të godinës ku janë vendosur qendrat e votimit duke plotësuar një procesverbal të posaçëm, i cili i bëhet me dije menjëherë sekretarit të KZAZ-së. Ky i fundit, pasi verifikon vërtetësinë e informacionit dhe në rast të mosmarrjes së vendimit nga ana e KZAZ-së për të kërkuar ndërhyrjen e

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Policisë së Shtetit për rivendosjen e rendit në qendrën e votimit njofton shefin e komisarariatit ose drejtorin e policisë me një kërkesë tip të miratuar sipas këtij urdhri. Urdhri parashikon se në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët e Komisioneve të Zonave të Qendrës së Votimit, zgjedhësit në radhë për të votuar, vëzhguesit e akredituar, përfaqësuesit e akredituar të medias, punonjësit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe punonjësit e Policisë së Shtetit të caktuara me shërbim pranë asaj qendre votimi. Urdhri parashikon ndalimin dhe qëndrimin apo grumbullimin në mjediset e brendshme dhe të jashtme të Qendrës së Votimit në oborrin e ndërtesës në hyrje të saj në korridoret e brendshme të ndërtesës ku janë vendosur qendrat e votimit dhe për rreth tyre në një distancë rrethore me rreze më të vogël se 150 metra, përveç personave të përcaktuar në këtë urdhër. Në urdhër përcaktohet se zgjedhësi, i cili shkon për të votuar drejtohet por në hyrjen e qendrës së votimit, vendoset në radhë dhe pasi ka përfunduar procesin e votimit duhet të largohet menjëherë nga qendra e votimit si dhe nga ambientet e tjera të brendshme apo nga oborri i godinës ku është vendosur qendra e votimit. Komisioni i Qendrës së Votimit merr vendim për pezullimin e vendimit dhe njofton KZAZ-në dhe Policinë e Shtetit në rastin kur verifikohet mosrespektimi i parashikimeve të këtij urdhri. Në rast se Komisioni i Qendrës së Votimit nuk merr vendim, anëtarët apo sekretari i Komisionit të Qendrës së Votimit që konstaton këtë fakt mban një procesverbal dhe njofton menjëherë KZAZ-në përkatëse dhe KQZ-në. Në rast se KZAZ-ja nuk merr vendim për të njoftuar Policinë e Shtetit atëherë sekretari i KZAZ-së njofton menjëherë KQZ-në dhe organet e Policisë së Shtetit nëpërmjet formularit për kërkimin e ndihmës së Policisë së Shtetit për të marrë masat e nevojshme për të larguar personat që nuk lejohen të qëndrojnë pranë ambienteve të qendrave të votimit. KAS-i sa përcaktohet më sipër çdo anëtar i qendrës së votimit i KZAZ-së apo vëzhguesi i subjektit zgjedhor kur konstaton shkelje të këtij urdhri,

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

apo akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në lidhje me praninë e personave të paautorizuar në mjediset e brendshme të jashtme të qendrës së votimit, mund të njoftojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet numrit të telefonit të vënë në dispozicion të administratës zgjedhore apo aplikacioneve *Whatsap* dhe *Telegram* që përdoren nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ky projektakt iu është dërguar edhe subjekteve zgjedhore, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Për sa më sipër ju paraqesim për vlerësim dhe miratim projekt urdhrin.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Përfaqësuesi i koalicionit “Bashkë Fitojmë”.

Z. Dh. Zguro: Faleminderit! Si përfaqësues i koalicionit “Bashkë Fitojmë” ne duam të bëjmë dy sugjerime të vogla dhe dy kërkesa të vogla. Parimisht jemi dakord me urdhrin, e inkurajojmë këtë lloj vendimmarrjeje, por sikundër edhe u relatua në zgjedhjet e mëparshme kemi hasur vonesa në ndërhyrjen e policisë ose të organeve ligjzbatuese. Pra, për të shmangur këto vonesa ne sugjerojmë që në urdhër të vendoset si pikë e posaçme që në rast se Komisioni i Qendrës së Votimit nuk arrin dot në vendimmarrje, ose nuk merr dot vendim për një arsye ose një tjetër, të lejohet që një anëtar i Qendrës së Votimit të mund të lajmërojë forcat e rendit drejtpërdrejtë, dhe kjo mundësi t’i jepet, gjithashtu, një anëtari, jo sekretarit, por një anëtari të KZAZ-së. Pra, këto do të ishin kërkesat tona në mënyrë që procesi, siç është shkruar në urdhër, të mos kalojë në dy ose tri hallka, të cilat do të bënin të mundur vonesa të shumta në ndërhyrjen e forcave të rendit dhe do të binte efikasiteti i zbatimit të urdhrin në gjykimin dhe vlerësimin tonë.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Pra, ju propozoni që qoftë edhe një anëtar i vetëm i Komisionit të Qendrës së Votimit apo qoftë edhe një anëtar i vetëm i KZAZ-së ta

*Zbardhi materialin audib
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

njoftojë Policinë e Shtetit për situatën e grumbullimit të njerëzve, të personave të cilët qëndrojnë në qendër.

Z. Dh. Zguro: Po, në rast se konstatohet thyerje e rregullave të këtij urdhri të mund të njoftohet drejtpërdrejtë ose nga një anëtar i Komisionit të Qendrës së Votimit, ose nga një anëtar i vetëm i KZAZ-së.

Z. I. Celibashi: Mirë dakord me këtë propozim. Unë jam dakord. Do ta përfshijmë në draft këtë propozim. Me shtesën besoj se jemi dakord që njëkohësisht të njoftojë edhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Pra, të vendoset të vërë në dijeni Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, qoftë edhe një anëtar i vetëm. Besoj se kjo do të jetë më e thjeshtë më pas me vënien në funksionim të aplikacionit të KQZ-zë. Atëherë, do ta miratojmë projektaktin me ndryshimin e propozuar nga përfaqësuesi i koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Meqenëse nga përfaqësues të tjerë të partive të tjera politike të subjekteve të tjera nuk kemi kontribute, edhe pse iu është dërguar për konsultim, po kështu dhe organizatave të shoqërisë civile, e miratojmë. Ajo që mbetet e rëndësishme është që menjëherë do të duhet ta përcjellim dhe komunikojmë përmbajtjen e këtij urdhri tek anëtarët e Komisioneve, të Qendrave të Votimit kur mund të jetë rasti, por më së pari tek anëtarët e Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor.

Urdhri nr. 62

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

**03.05.2023
Ora, 12:31**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 14 prill-20 prill 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Znj. V. Ballgjini, Z. E. Mema,
Znj. I. Osmanaj, Znj. P. Doçaj.**
- **Parti Politike:** **BF (F. Nuri)**
- **Të tjerë:** **KRIIK, OSBE/ODIHR, Qëndresa
Qytetare, (Dh. Zguro)**

Z. I. Celibashi: Kalojmë të pika tjetër ë ka të bëjë me vlerësimin e raportimeve për veprimtarinë e institucioneve publike për periudhën 14 prill -20 prill.

Znj I. Osmanaj: Gjatë periudhës 14 prill-20 prill 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike janë raportuar gjithsej 209 aktivitete nga 51 institucione publike. Nga verifikimi paraprak rezulton se nga këto 4 aktivitete të zhvilluara nga 4 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Struktura përgjegjëse ka administruar përgjigjet e dërguara nëpërmjet adresës së emailit nga institucionet, si: Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor,

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Bashkia e Sarandës, dhe Bashkia e Libohovës. Arsyet e raportimit me vonesë të tejkalimit të afatit ligjor lidhen me: Ministria e Kulturës bën me dije se nuk është një veprimtari me karakter publik, por është veprimtari me karakter institucional me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të artizanit. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor bën me dije se gabimisht ka raportuar agjendën politike të drejtorit të përgjithshëm duke marrë parasysh edhe faktin se data e zhvillimit ishte ditë pushimi zyrtar. Bashkia e Sarandës bën me dije se për shkak të tematikës së cilës i referohet dhënie iftari, për shkak dhe orarit të zhvillimit, vlerëson se nuk është veprimtari me karakter publik që ka detyrim për raportim. Bashkia e Libohovës bën me dije se për shkak të tematikës duke marrë parasysh faktin se edhe data e zhvillimit është ditë e shtunë pushim zyrtar për administratën publike, nuk është veprimtari me karakter publik që ka detyrim për raportim. Në këto kushte propozojmë mos konstatimin e shkeljes administrative dhe pushim e procedimit administrativ ndaj institucioneve si Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, Bashkia e Sarandës dhe Bashkia e Libohovës. Ndërkohë sjellim në vëmendje që KQZ-ja po monitoron në baza ditore veprimtaritë e raportuara me vonesë të respektimit të afatit 5 ditor dhe veprimtarisë me pjesëmarrjen e personave partiakë. Nga këto veprimtari janë ndaluar në total deri tani 37 veprimtari publike nga të cilat 19 veprimtari janë ndaluar për shkak të pjesëmarrjes së personave partiakë dhe 18 veprimtari për mos respektim të afatit të raportimit. Njëkohësisht gjatë kësaj periudhe janë caktuar dhe monitorues për 124 veprimtari të institucioneve të ndryshme publike për të vëzhguar nëse këto aktivitete do të mbahen duke respektuar dispozitat ligjore të Kodit Zgjedhor dhe nëse prezenca e deputetëve do të krijojë mundësinë për politizimin e aktivitetit si dhe fjalimet që ata mbajnë, apo përdorimi i materialeve propagandistike. Gjithashtu, për të njëjtën periudhë raportimi pas administrimit të përgjigjeve të dërguara nga institucionet publike në

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

lidhje me çështjet objekt shqyrtimi kemi edhe denoncimet për të cilat kemi vlerësuar që do të bëhet edhe shpallja e vendimeve në seancën e sotme. Pas zhvillimit të seancës publike të datës 24.06.2023, ku palët janë thërritur në proces për të bërë shpjegimet e tyre përfundimtare, vlerësojmë pushimin e procedimit administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për Bashkinë e Beratit, për dy veprimtari publike të pa raportuara të regjistruara me numër regjistri 318 dhe 319 ID, për Bashkinë e Cërrikut për një veprimtari të zhvilluar përpara datës së raportuar regjistruar me numër regjistri 321 ID, për Bashkinë e Shkodrës për një veprimtari publike të pa raportuar regjistruar me numër regjistri 314 ID, për Bashkinë e Devollit për një veprimtari publike të pa raportuar, regjistruar me numër regjistri 2187 ID, për Bashkinë e Dimalit për një veprimtari publike të pa raportuar regjistruar me numër regjistri 290 ID, për Bashkinë e Belshit për 3 veprimtari publike të pa raportuara regjistruar me numër 294, 302 dhe 303 ID, për Bashkinë e Elbasanit për një veprimtari publike të pa raportuar, regjistruar me numër regjistri 300 ID, për Bashkinë e Himarës për një veprimtari të pa raportuar, regjistruar me numër regjistri 299 ID, për Bashkinë e Mallakastrës për dy veprimtari publike të pa raportuara, regjistruar me numër regjistri 295 dhe 301 ID, për bashkinë e Beratit për një veprimtari të zhvilluar para datës së raportuar, regjistruar me numër regjistri 322 dhe 324 ID, për Bashkinë e Fushë Arrzit për një veprimtari publike të pa raportuar regjistruar me numër regjistri 304 ID dhe për Bashkinë e Tiranës për një veprimtari publike të pa raportuar, regjistruar me numër regjistri 306 ID. Për të gjitha këto denoncime, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave kemi konstatuar se nuk jemi në kushtet e shkeljeve të dispozitave të Kodit të Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator. Gjithashtu, përtej kësaj periudhe raportimi kemi denoncime, që janë regjistruar me numër regjistri 338 ID, ndaj Bashkisë së Vlorës për një veprimtari me përdorim të burimeve publike, denoncues është Komiteti Shqiptar i

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Helsinki. Pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre, si dhe pas zhvillimit të seancës publike me datën 26.04.2023, vlerësojmë se për t'u konstatuar shkelje duhet domosdoshmërisht plotësimi njëkohësisht i dy elementeve të përdorimit të detyruar brenda orarit zyrtar të punës së punonjësve dhe përdorimi i tyre për qëllime zgjedhore sikurse përcaktohet në dispozitat e Kodit Zgjedhor. Fakti që aktiviteti është organizuar nga një parti politike, e cila në momentin e zhvillimit të aktivitetit nuk ka qenë ende e regjistruar për zgjedhjet e datës 14 maj dhe nuk ka pasur as kandidat për kryetar bashkie apo këshillat bashkiakë, nuk provojnë kushtin e qëllimit zgjedhor, për këtë arsye, bazuar në fakte dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ vlerësojmë se duhet të pushohet çështja që ka për objekt takimin me gratë sipërmarrëse në qytetin e Vlorës të organizuar nga Partia Socialiste dega Vlorë. Gjithashtu, kemi vendimin e regjistruar me numër regjistri 229 ID, denoncues është organizata Qëndresa Qytetare.

Z. I. Celibashi: Kur ishte zhvilluar ky aktivitet?

Znj. I. Osmanaj: Në Vlorë. Në ambientet e një subjekti.

Z. I. Celibashi: Data?

Znj. I. Osmanaj: Më datën, këtu nuk e kam, por e di që është, po në datën...

Z. I. Celibashi: Meqenëse lidhet me periudhën para se të regjistrohet Partia Socialiste si subjekt zgjedhor je duke thënë.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Znj. I. Osmanaj: Po, përpara datës së regjistrimit të subjektit zgjedhor, në mos gaboj ka qenë në datën 3 mars.

Z. I. Celibashi: Po ç'a e ndryshon kjo situatën ka qenë apo nuk ka qenë si subjekt zgjedhor?

Znj. I. Osmanaj: Nuk ka qenë i regjistruar si subjekt zgjedhor Partia Socialiste.

Z. I. Celibashi: Po pra por aktiviteti kur është zhvilluar dhe ata që kanë marrë pjesë në aktivitet kjo ka rëndësi edhe pse nuk e ka zhvilluar atë...

Znj. I. Osmanaj: Aktiviteti është zhvilluar në ambientet e një lokali.

Z. I. Celibashi: Në fakt, ky është regjistruar edhe si subjekt zgjedhor, nuk e zhvesh nga ajo që është parti politike dhe, nëse veprimtaria politike e kësaj partie politike është zhvilluar në kushtet e përdorimit të aseteve publike që është keqpërdorim jemi në të njëjtën situatë, nuk ka rëndësi.

Znj. I. Osmanaj: Nuk kemi as rastin e përdorimit të përdorimit të aseteve publike, nuk jemi as në rastin e përdorimit të gjatë fushatës ose të punonjësve të një institucioni publik, dhe për rrjedhojë kemi konstatuar se nuk jemi në kushtet e një shkeljeje administrative.

Z. I. Celibashi: Këta pjesëmarrësi kanë qenë punonjësit e një biznesi privat, të një kompanie private?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Znj. I. Osmanaj: Po. Dhe kjo gjë u provua edhe gjatë hetimit administrativ.

Z. I. Celibashi: Dakord! Vazhdojmë.

Znj. I. Osmanaj: Në lidhje me denoncimin, regjistruar me numër 229 ID ndaj Bashkisë së Vlorës me objekt: aktiviteti i deputetit zotit Blendi Klosi me të rinjtë votues për herë të parë në qytetin e Vlorës i zhvilluar në ambientet e kinemasë së qytetit dhe i publikuar në rrjetin e social në datën 1 mars, pasi kemi administruar përgjigjet e palëve, sikurse dhe i kemi thërritur për të marrë pjesë në seancë publike, vlerësojmë se mënyra e funksionimit dhe qëllimi i përdorimit të këtyre ambienteve siç është kinemaja e qytetit rregullohen me disa dispozita ligjore të veçanta. Ligji i posaçëm prevalon në zbatimin e tij në dispozitat e përgjithshme siç është Kodi Zgjedhor. Vlerësojmë se ambientet që për shkak të funksionit dhe mundësive akomoduese që ofrojnë dhe kur dhënia në përdorim e tyre bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të caktuara mund të përdoret nga subjektet zgjedhore. Sa i përket pretendimit të pjesëmarrjes së të rinjve në këtë aktivitet elektorale pa vullnetin e lirë të tyre vlerësojmë se do të konstatohet shkelja nëse do të vërtetohej përdorimi i detyruar i tyre, si dhe organizimi i aktivitetit brenda orarit mësimor. Gjatë hetimit administrativ nuk u arrit të provohej pjesëmarrja me detyrim dhe brenda orarit mësimor të të rinjve. Gjithashtu, konsiderojmë të arsyeshme të sqarohet dhe terminologjia “votues për herë të parë”, jo domosdoshmërisht referon për nxënësin pjesë e sistemit shkollor parauniversitar. Për sa më sipër bazuar në fakte dhe në provat e administruara vlerësojmë që duhet të pushohet hetimi administrativ dhe për këtë rast.

Z. I. Celibashi: Çfarë numri ka ky denoncimi?


*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Znj. I. Osmanaj: Numër 229 ID. Gjithashtu, kemi denoncimin e regjistruar me numër 335 dhe 336 ID ndaj Bashkisë së Kukësit, sikurse dhe drejtorëve të dy shkollave në Bashkinë e Kukësit, për dy veprimtari me përdorim të burimeve publike. Denoncues është Qëndresa Qytetare; objekti i këtyre denoncimeve ka të bëjë takimi i zhvilluar në ambientet e oborrit të shkollës “Isuf Seferi” në fshatin Grykë Çaj, të zotit Safet Gjici dhe zonjës Dallëndyshe Bici, drejtore e përgjithshme Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me banorët e zonës. Takimi dytë është takimi kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kukësit, njëkohësisht dhe kryetari i bashkisë, zoti Safet Gjici dhe Dallëndyshe Bici Drejtore e përgjithshme e Agjencisë së Kadastrës zhvilluar në oborrin e shkollës 9-vjeçare “Shaban Murati” me banorët e zonës. Pasi kemi administruar përgjigjet e palëve, pasi kemi thërritur dhe palët në proces për të dhënë shpjegimet e tyre përfundimtare vlerësojmë se veprimtaria e kryer në ambientet e shkollës 90- vjeçare “Isuf Seferi” është veprimtari me karakter publik, e cila nuk rezulton të jetë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së. Rezultoi se kryetari i bashkisë së Kukësit me zhvillimin e veprimtarisë publike në ambientet e shkollës ka përdorur burime publike si në mbështetje të tij. Kryetari në detyrë nuk mund të përdorë institucionet publike në interes të fushatës elektorale. Referuar pjesëmarrjes së zonjës Bici në këto aktivitete nuk rezulton e provuar pjesëmarrja e saj në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës pasi takimet e zhvilluara nuk provohet të kenë pasur lidhje me natyrën funksionale apo të ketë thënie elektorale në këto aktivitete. Çdo person, pavarësisht postit që mban si funksionar i partisë ku aderon, mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete dhe të shprehë mendimet e veta apo preferencat politike, gjithmonë pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore. Vihet re që ky takim është zhvilluar ditën e diel në datën 16 prill. Për sa më sipër, bazuar në fakte dhe provat e

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

administruara gjatë hetimit administrativ, vlerësojmë se zonja Bici nuk gjendet në shkelje të dispozitave në fuqi , për pasojë propozojmë që duhet të pushohet shqyrtimi administrativ, ndërsa sa i takon zotit Safet Gjici në cilësinë e kryetarit të Bashkisë dhe drejtorit të shkollës “Isuf Seferi”, zotit Rustem Dervishi gjendemi në shkelje të nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor dhe pikës 2 të nenit 3 të vendimit 9 të Komisionit Rregullator. Ndërsa në lidhje me aktivitetin e dytë për kryerjen e një aktiviteti publik në ambientet e shkollës 9- vjeçare “Shaban Murati”, nga prova e administruara...

Z. I. Celibashi: Lidhur me aktivitetin e parë, kemi dhe mos raportim të aktivitetit.

Znj. I. Osmanaj: Nuk është raportuar si aktivitet.

Z. I. Celibashi: Ose ka qenë aktivitet institucional, ose dhe do të duhej të ishte raportuar ose ka qenë aktivitet politik dhe në këtë rast jemi në shpërdorim të aseteve dhe fondit të mjeteve publike. Thatë që ky është rasti kur është zhvilluar aktiviteti në oborrin e shkollës. Aktiviteti ka qenë elektoral.

Znj. I. Osmanaj:: Nga sa deklarohet nga palët, nga personi përgjegjës për Bashkinë e Kukësit, po.

Z. I. Celibashi: Atëherë jemi para rastit kur kemi një keqpërdori të aseteve publike. Ky është rasti. Kurse për drejtuesen e ASHK-së meqenëse aktiviteti është zhvilluar ditën e diel, dhe kjo është e provuar, edhe pse ka qenë politik nuk e bën atë përgjegjëse për pjesëmarrjen në këtë aktivitet. Ka pasur personel? Apo këtë nuk e dimë.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Znj. I. Osmanaj: Kjo nuk provohet.

Z. I. Celibashi: Rasti tjetër është për shkollën tjetër.

Znj. I. Osmanaj: Në lidhje me kryerjen e aktivitetit në ambientet e shkollës...

Z. I. Celibashi: Pra, nuk ka lidhje mosraportimi për rastin e parë, sepse aktiviteti ka qenë nuk ka pasur detyrim për ta raportuar por ndërkohë kemi këtë shkeljen tjetër.

Znj. I. Osmanaj: Ndërsa në lidhje me kryerjen e aktivitetit publik në ambientet e shkollës 9- vjeçare “Shaban Murati”, nga provat e administruara vërehet se këto ambiente nuk janë të rrethuara me mure duke bërë të mundur që të aksesohen lehtësisht nga publiku dhe nuk mund të provohet se janë vënë në dispozicion nga drejtori i shkollës për kryerjen e këtyre takimeve. Në këtë rast vlerësohet se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ ndaj drejtorit të shkollës Betim Lushi, pasi nuk jemi përballë shkeljes së nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit numër 9 të Komisionit Rregullator.

Z. I. Celibashi: Për rastin e parë kam përshtypjen se është më e qartë situata e shkeljes së ligjit. Jemi para përdorimit të ambienteve publike për qëllime elektorale, ambiente të cilat nuk mund të përdoren dhe për këtë do të ketë sanksion për personat përgjegjës. Për rastin e dytë e kemi të qartë çfarë natyre ka pasur aktiviteti?

Znj. I. Osmanaj: Ne administrojmë vetëm foto. nuk kemi të administruara video për të kuptuar nëse ka pasur thirrje elektorale apo fjalime të kësaj natyre, por ajo që

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

vërehet si edhe pas konstatimeve dhe gjetjeve të monitoruesit që është dërguar në këto ambiente për të verifikuar në rastin e shpërdorimit të burimeve publike, pra a ka mur rrethues nëpër këto shkolla, apo jo, kemi administruar raportin që thotë se nuk ka mur rrethues dhe për rrjedhojë ne nuk kemi konstatuar...

Z. I. Celibashi: Mund të mos ketë mur rrethues, por në qoftë se është bërë në atë ambientin që është oborri funksional i shkollës, do të thotë se është bërë në ambientin e shkollës dhe do të duhet thjesht dhe vetëm të verifikojmë, nëse ka qenë aktivitet elektoral apo ka qenë aktivitet institucional. Nëse ka qenë aktivitet institucional dhe nuk është raportuar, do të sanksionohet për mosraportim. Nëse është aktivitet politik dhe e provojmë këtë, do të duhet ta sanksionohet për zhvillimin e një aktiviteti politik dhe elektoral në një ambient publik. Po fjala është për përfaqësuesin e Qëndresës..

Z. Dh. Zguro: Po, Dhimitër Zguro, përfaqësues i Qëndresës Qytetare për rastin e shkollës "Lusen" është qartazi një aktivitet politik. Qëndresa Qytetare ka vendosur në dispozicion linkun ku mund të gjendet edhe videoja dhe është një video në cilën vetë drejtoresha e përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës tekstualisht thotë se jam këtu me bekimin e Kryeministrit të Shqipërisë për të mbështetur njeriun e punës Safet Gjicin jo për të patur fitore, sepse kjo është e sigurt, për të patur një fitore sa më të sigurt, kështu që edhe për këtë rast kërkojmë në vijim edhe të seancës publike, që është mbajtur, ndëshkimin qoftë të drejtoreshës së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, sepse detyra e saj funksionale vazhdon edhe në rast se është e shtunë dhe e diel, sepse detyra funksionale e një funksionari publik i përfundon vetëm me përfundimin e detyrës së tij, edhe të drejtorit të shkollës, sepse provohet që, të paktën, në provat që ne kemi sjellë që janë ambientet e shkollës. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Z. I. Celibashi: E kemi këtë se linku...

Znj. F. Osmanaj: Linkun e administrojmë, por ai nuk hapet, e vetnja gjë që ne kemi administruar dhe nga kërkimet tona, sikurse edhe nga raporti monitorues, janë fotot të cilat provojnë se kjo shkollë ka vetëm një mur rrethues dhe nuk kemi...

Z. I. Celibashi: Çështjen e murit e kemi parë edhe në fotografitë që janë bërë në ambientin funksional të shkollës. Në gjykimin dhe vlerësimin tim, për të provuar mbi përmbajtjen e aktivitetit, natyrën e aktivitetit do të na duhet të shikojmë videon, por po e shtyjmë për të na krijuar mundësi përfaqësuesit e “Qëndresës” për ta parë atë video, meqenëse linku që keni dërguar nuk hapet, nuk e aksesojmë dot përmbajtjen e këtij linku. Dakord? Po përfaqësuesi i Qëndresës dakord, besoj?

Z. Dh. Zguro: Kuptoj, unë po mundohem në këto momente është...

Z. I. Celibashi: S’ka gjë, merre me qetësi, shkarkoje, domethënë ose na e përcillni në ndonjë mënyrë që edhe e vlerësojmë, dakord?

Z. Dh. Zguro: Dakord.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

03.05.2023
Ora, 12:50

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 252 ID, 253 ID, 254 ID, dhe 286 ID të deputetes znj, Albana Vokshi ndaj Kryetarit të Partisë Socialiste të Njesisë nr. 11, Tiranë.”

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Znj. P. Doçaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF (F. Nuri)**
- **OJQ:** **KRIK, OSBE/ODIHR,
Qëndresa Qytetare**

Z. I. Celibashi: Mos hamë kohën për çështjet e tjera. Atëherë vazhdojmë me shqyrtimin e denoncimeve nr. 281, 239, 240, 241, 242. Denoncimi 281 lidhet me Bashkinë e Përrenjasit, denoncimet 239, 240, 241, 242 i KRIK-ut, sikurse edhe denoncimet e cituara më sipër, këto denoncimet e fundit lidhen me veprimtarinë e Bashkisë së Elbasanit. Denoncimi, po i KRIK-ut me nr. 210 lidhet me veprimtarinë e Bashkisë së Belshit, këto janë.

Znj. I. Osmanaj: Përpara fillimit doja t’ju bëja me dije se në lidhje me denoncimet e administruara me nr 252, 253, 254 dhe 286 ID, pak më parë kemi administruar

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

një email, nëpërmjet të cilit përfaqësuesi i “Tirana Parking” kërkon një shtyrje të seancës për arsye shëndetësore.

Z. I. Celibashi: Dakord, e shtyjmë. Vazhdojmë. Kjo është pika e 13-të e rendit të ditës, që kërkohet të shtyhet, po.

*Zbardhi materialin audio
Eneta STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

03.05.2023
Ora, 12:52

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 281 ID, 239 ID, 240 ID, 241 ID, 242 ID, 210 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj Bashkive Përrenjas, Elbasan dhe Belsh”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafi KQZ: **Znj. P. Doçaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF (F. Nuri)**
- **OJQ:** **KRIK, OSBE/ODIHR,
Qëndresa Qytetare**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me të tjerat.

Znj. I. Osmanaj: Kemi administruar denoncimin për Bashkinë e Përrenjasit për një veprimtari më përmbajtje elektorale, regjistruar me nr. 281 ID. Denoncues është KRIK-u, nëpërmjet të cilit denoncon takimin e kryetarit të Bashkisë së Përrenjasit dhe drejtuesit politik të qarkut të Elbasanit, zotin Damian Gjikhuri, me banorë të zonës së Rrashtanit, me rastin e përfundimit dhe të rehabilitimit të rrugës në këtë fshat. Aktiviteti është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, sipas afateve dhe janë deklaruar edhe pjesëmarrësit. Ky aktivitet është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë së Përrenjasit, në faqen e kryetarit e bashkisë dhe në të tria rastet vihet re

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

prania e sloganeve elektorale të Partisë Socialiste. Pasi kemi administruar denoncimin i kemi dërguar kërkues për informacion personit përgjegjës për Bashkinë e Përrenjasit, nëpërmjet së cilës kemi administruar përgjigjen si vijon: “Aktiviteti është raportuar në datën 31 mars dhe ka qenë i hapur për median dhe publikun. Në fjalimin e tij kryetari i bashkisë nuk ka bërë premtime elektorale dhe as nuk ka përmendur fushatë zgjedhore, kështu që asnjë burim publik në administrimin e bashkisë nuk konsiderohet si përdorim në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Ftesa për deputetin e qarkut, zotin Gjikhuri, është bërë pasi ai është deputet i këtij qarku dhe ka tërësisht legjitime pjesëmarrjen në inspektimin e punëve publike të zonës së tij elektorale. Kemi thërritur palët për të marrë pjesë në seancën e sotme publike, por rezulton që nuk janë paraqitur. Kemi denoncimin ndaj Bashkisë së Elbasanit për katër veprimtari publike me përmbajtje elektorale regjistruar me numër regjistri 239, 240, 241 dhe 242, ID.

Z. I. Celibashi: Më fal, kur ishte zhvilluar ky aktiviteti i Përrenjasit?

Znj. I. Osmanaj: Në Përrenjas

Z. I. Celibashi: Kur?

Znj. I. Osmanaj: Në zonën e Rrashtanit, në datën 31 mars.

Z. I. Celibashi: Dakord.

Znj. I. Osmanaj: Vazhdojmë me Bashkinë e Elbasanit, ku denoncuesi është KRIIK-u. Objekti i këtyre denoncimeve ka të bëjë me inspektimin e punimeve për

*Zbardhi materialin audio
Enxhela STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

rehabilitimin e plotë të rrugëve në lagjen “Haxhias” dhe “5 Maji”, me pjesëmarrjen e kryetarit të bashkisë dhe drejtuesit politik të qarkut, zotin Damian Gjikhuri dhe ministres së Arsimit dhe Sportit zonjën Evis Kushi. Takimi i dytë ka të bëjë me takimin me rastin e fillimit të punimeve për rehabilitimin dhe asfaltimin e rrugëve në fshatin Gjonen, njësia administrative Gjorgjan, me pjesëmarrjen e kryetarit të bashkisë dhe drejtuesin politik të qarkut, zotin Gjikhuri dhe deputeten, zonjën Desantiela Tahiraj. Takimi i tretë ka të bëjë me inspektimin punimesh për rehabilitimin e rrugës në fshatin Kusar, njësia administrative Bradashesh, me pjesëmarrjen e kryetarit të bashkisë dhe drejtuesit politik zotin Gjikhuri. Takimi i katërt ka të bëjë me një inspektim punimesh për rehabilitimin e rrugës “Riza Salla” Shushicë, me pjesëmarrjen e zotit Gjikhuri dhe deputetes zonja Desantila Tahiraj. Të katërt aktivitetet janë publikuar në faqen zyrtare të kryetarit të bashkisë, të zotit Gjikhuri, dhe të ministres, zonjës Kushi. Aktivitetet rezultojnë të jenë transmetuar edhe në disa media kombëtare. Aktivitetet janë raportuar në ndërfaqen e KQZ –së brenda afateve ligjore. Këto janë ato që pretendohen nga denoncuesi. Pas administrimit të denoncimeve, në kuadër edhe të procedurës, kemi dërguar kërkesë për informacion personit përgjegjës për Bashkinë e Elbasanit, i cili në përgjigje për të katërt aktivitetet ka bërë me dije se në fjalën e kryetarit të bashkisë, tek asnjëri nga aktivitetet nuk ka thirrje politike, diskutime apo premtime elektorale, kanë qenë thjesht bashkëbisedime me qytetarët mbi nevojat e komunitetit dhe zgjidhje të mundshme që ofron bashkia. Lidhur me pjesëmarrjen e drejtuesit politik dhe deputetes në këto takime thekson se vjen për shkak të funksionit politik që këta kanë dhe fjala e tyre i përmbahet këtij formati. Nga ana e bashkisë këto aktivitete janë raportuar në kohë, si dhe janë deklaruar personat pjesëmarrës që do të jenë në këtë aktivitet. I kemi thërritur palët për të marrë pjesë në seancën e sotme publike, por rezultojnë që nuk janë paraqitur. Kemi denoncim ndaj Bashkisë së Belshit për

*Zbardhi materialin audio
Enëida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

një veprimtari me përmbajtje elektorale, regjistruar me numër regjistri 210 ID, denoncues është KRIK-u, ku nëpërmjet të cilit denoncon takimin me fermerët e Belshit dhe Dumresë për krijimin e grupit vendor të veprimit, me pjesëmarrjen e kryetarit të bashkisë dhe drejtuesit politik të qarkut të Elbasanit, zotit Damian Gjikhuri. Takimi është publikuar në rrjetin social të kryetarit të bashkisë dhe të zotit Gjikhuri, gjithashtu, pretendohet se ky aktivitet është raportuar në ndërfaqe, por nuk parashikon pjesëmarrje në të të drejtuesit politik. Pas administrimit të denoncimit i kemi dërguar kërkesë për informacione personit përgjegjës për Bashkinë e Belshit, por nuk kemi administruar përgjigje. I kemi thirrur për të marrë pjesë në seancën e sotme, për të dhënë shpjegimet e tyre, por rezulton që nuk janë paraqitur.

Z. I. Celibashi: Denoncimi, po i KRIK-ut me nr. 210 lidhet me veprimtarinë e Bashkisë së Belshit, këto janë.

Znj. I. Osmanaj: Kemi denoncim ndaj Bashkisë së Belshit për një veprimtari me përmbajtje elektorale, regjistruar me numër regjistri 210 ID, ku denoncues është KRIK-u, nëpërmjet të cilit denoncon takimin me fermerët e Belshit dhe Dumresë për krijimin e grupit vendor të veprimit, me pjesëmarrjen e kryetarit të bashkisë dhe drejtuesit politik të qarkut të Elbasanit, zotit Damian Gjikhuri. Takimi është publikuar në rrjetin social të kryetarit të bashkisë dhe të zotit Gjikhuri, gjithashtu, pretendohet se ky aktivitet është raportuar në ndërfaqe, por nuk parashikon pjesëmarrje në të të drejtuesit politik. Pas administrimit të denoncimit i kemi dërguar kërkesë për informacione personit përgjegjës për Bashkinë e Belshit, por nuk kemi administruar përgjigje. I kemi thirrur për të marrë pjesë në seancën e sotme, për të dhënë shpjegimet e tyre, por rezulton që nuk janë paraqitur.

*Zbardhi materialin audio
Enëida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

03.05.2023
Ora, 12:57

RENDI I DITËS

*Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 283 ID, të deputetit zj. Albana
Vokshi, ndaj Zyrës Vendore Arsimore Vlorë dhe subjektit zgjedhor “Partia
Socialiste e Shqipërisë”*

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafi KQZ: **Znj. P. Doçaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. I. Osmanaj**
- **Parti Politike:** **PF (F. Nuri)**
- **OJQ:** **KRIK, KRIK, OSBE/ODIHR,
Qëndresa Qytetare**

Znj. I. Osmanaj: Kemi administruar denoncimin nga deputetja, zonja Albana Vokshi, për drejtorin e shkollës “Todi Koçeli” në Selenicë, për një veprimtari me përmbajtje elektorale, regjistruar me numër regjistri 283 ID, për të cilën pretendohet se instituti arsimor “Todi Koçeli” në Selenicë shpërndan statuset të kandidatëve në garën për zgjedhjet e datës 14 maj. Faqja zyrtare facebook e shkollës tregon përfshirjen e saj në aktivitete politike. I kemi dërguar kërkesën për informacion drejtorit të shkollës, sikurse dhe ZVA-së Selenicë, por deri tani nuk kemi administruar asnjë përgjigje. I kemi thirrur palët për të marrë pjesë në këtë proces shqyrtimi administrativ, por nuk janë paraqitur.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Di.03.05.2023*

Z. I. Celibashi: Po, ne kemi bërë verifikim të faqes së facebook-ut të shkollës dhe rezultojnë këto pretendime?

Znj. I. Osmanaj: Pretendimet rezultojnë, u janë bashkëlidhur edhe atash si foto palëve për t'i parë, por nuk kemi administruar asnjë përgjigje deri tani.

Z. I. Celibashi: Po, ju keni kërkuar që të japin përgjigje?

Z. I. Osmanaj: Po, brenda dy ditësh, por që s'kemi administruar

Z. I. Celibashi: Mirë, nëse ne kemi bërë verifikimet dhe rezulton e provuar, çfarë është pretenduar nga deputetja Albana Vokshi, atëherë ne jemi para rastit për të vendosur sanksion. Nuk kemi arsye për të pritur, sa kohë që ju keni kërkuar për të dhënë shpjegim, po çfarë shpjegimi do të japin, sepse, në fund të fundit, është e qartë që në faqen e rrjetit social të shkollës janë pasqyruar aktivitetet me karakter politik dhe elektoral, ndaj do të urdhërojmë që të fshihen këto postime dhe ndërkohë të sanksionohet me gjobë drejtuesi i institucionit. Kështu që e quajmë të mbyllur me vendimmarrje, nuk kemi nevojë më për të hetuar më shumë në lidhje me këtë.

Vendimi nr. 436

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

03.05.2023
Ora, 12:59

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 256 ID, të deputetes znj. Albana Vokshi ndaj Zyrës Vendore Arsimore Tiranë dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë”

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Znj. P. Doçaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF (F. Nuri)**
- **OJQ:** **KRIK, OSBE/ODIHR, Qëndresa
Qytetare**

Znj. I. Osmanaj: Kemi administruar denoncimin regjistruar me nr. 256 ID të deputetes, zonja Albana Vokshi, ndaj Partisë Socialiste, njësia 8 për një veprimtari me përmbajtje elektorale. Objekti i këtij denoncimi është takimi i koordinatores së Partisë Socialiste dhe ish-portierit të skuadrës “Partizani”, Bledi Nallbani, në shkollat e njësisë 8 në Tiranë, me nxënësit e shkollës. Postimet e këtij takimi janë bërë dhe në faqen elektronike faktor.al. Mbas administrimit të denoncimit kemi dërguar kërkesë për informacion subjektit zgjedhor Partia Socialiste për të kërkuar informacionin shpjegues për sa pretendohet nga denoncuesi, por nuk kemi

*Zbardhi materjalin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

administruar përgjigje. I kemi thirrur për të marrë pjesë në seancën e sotme publike, por nuk janë paraqitur.

Z. I. Celibashi: Ndërkohë keni kërkuar shpjegime dhe nga drejtuesit e institucionit arsimor?

Znj. I. Osmanaj: Edhe arsimor ZVA-ja.

Z. I. Celibashi: Po. Për natyrën e aktivitetit?

Znj. I. Osmanaj: Shpjegimet detajuese për sa pretendohet nga denoncimi brenda 2 ditësh nga ardhja e emailit.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

**03.05.2023
Ora, 13:01**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 337, të qendrës
“Qëndresa Qytetare” ndaj Këshillit të Ministrave.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Znj.P. Doçaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF (Z. Franci Nuri)**
- **Të tjerë:** **KRIK, OSBE/ODIHR, Qëndresa
Qytetare**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë.

Znj. I. Osmanaj: Gjithashtu, kemi edhe denoncimin ndaj Këshillit të Ministrave, regjistruar me numër regjistri 33.

Z. I. Celibashi: Jo, ke....

Znj. I. Osmanaj: Janë këto çështje që është kërkesa për shtyrje.

Z. I. Celibashi: Jo, kemi 252, 253, 254 dhe 286 ndaj kryetarit Partia Socialiste njësia nr. 11.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Znj. I. Osmanaj: Po, është çështja që kërkoi kërkesë për shtyrje, e kemi administruar.

Z. I. Celibashi: Kjo është?

Znj. I. Osmanaj: Po, kjo është çështja. Dhe më pas kemi çështjen ndaj Këshillit të Ministrave, regjistruar me numër regjistri 337 ID. Denoncuese është Qëndresa Qytetare për një veprimtari me përdorim të burimeve publike. Objekti i këtij denoncimi është miratimi i vendimeve për shpërblimin e pensionistëve për vitin 2023 nga ana e Këshillit të Ministrave. Pretendimet e Qëndresës Qytetare janë se miratimi i këtij vendimi është në shkelje të Kodit Zgjedhor, që ndalon nxjerrjen e akteve të tilla, që parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuar jo më afër se 4 muaj para datës së zgjedhjeve, vendim në shkelje të Kodit Zgjedhor, që ndalon përdorimin e burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Palët i kemi ftuar për të marrë pjesë në seancën e sotme publike, për të dhënë edhe shpjegimet e tyre përfundimtare dhe në seancë është paraqitur përfaqësuesi i organizatës Qëndresa Qytetare, sikurse dhe përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave.

Z. I. Celibashi: Po ia japim fjalën përfaqësuesit të Qëndresës, pastaj përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave.

Z. Dh. Zguro: Përhëndetje, i nderuar Komisioner! Me datë 31.03.2023 Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 187 për shpërblimin e pensionistëve për vitin 2023. Sipas këtij vendimi një kategori e caktuar pensionistësh dhe një kategori e caktuar e subjekteve që përfitojnë nga shpërblimet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore do të shpërblehen në masën 5 mijë lek për muajin prill. Në

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

këndvështrimin tonë, gjithashtu, VKM-ja ka përcaktuar edhe shumën e efekteve që financiarisht do të ketë, që është tre miliardë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë lekë, do të jetë efekti në buxhetin e shtetit për sa i takon kësaj VKM –je. Në këndvështrimin tonë kjo VKM, pikë së pari, bie ndesh, në kundërshtim të hapur dhe flagrant me nenin 91 pikën 4 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet qartë se 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisjes së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi i akteve, që synojnë apo favorizojnë, apo shpërblejnë kategori të caktuara, ndër këto kategori edhe kategorinë e pensionisteve. Së pari, nëse Këshilli i Ministrave, sikurse ka pretenduar edhe Kryeministri, do të ecin me interpretimin e nocionit të qeverisë së re, gjykojmë se nocioni i qeverisë së re duhet të përfshijë edhe qeverisjen vendore. Së pari, standardet demokratike të zgjedhjeve janë të njëjta si për zgjedhjet vendore, ashtu si edhe për zgjedhjet e përgjithshme, kështu që nuk ka asnjë kuptim apo logjike që një dispozitë, pjesë e nenit 91, të interpretohet në mënyrë të shkëputur dhe jo në mënyrë sistematike nga dispozitat e tjera të Kodit Zgjedhor, të cilat ngrenë disa parashikime, me qëllim ruajtjen e integritetit të zgjedhjeve dhe parandalimin e shpërdorimit të burimeve publike. Në të njëjtën kohë, sipas interpretimit të zgjeruar, qeverisja e re duhet të përfshijë edhe nocionin e qeverisjes lokale dhe po t'i referohemi Kushtetutës së Shqipërisë edhe Kushtetuta e Shqipërisë bën një diferencim mes qeverisjes qendrore dhe qeverisjes lokale, duke përcaktuar në mënyrë të qartë se organet e njësisë së qeverisjes vendore janë bashkitë, komunat dhe qarqet dhe secili prej këtyre organeve e ushtron pushtetin që kanë nëpërmjet organeve përfaqësuese, të cilat zgjidhen të konstituohen menjëherë pas zgjedhjeve. Në të njëjtën kohë në interpretim dhe në frymë të ligjit është e qartë që i gjithë Kodi Zgjedhor parandalon dhe ndalon përdorimin e aseteve publike, dhënien e shpërblimeve, ndaj kategorive të caktuara gjatë periudhës 4

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

mujore, me qëllim mosfavorizimin e një force të caktuar politike apo një subjekti të caktuar zgjedhor dhe parandalimin e këtyre fenomeneve. Dhe po t'u referohemi vetë ndryshimeve dhe relacionit të Kodit Zgjedhor, relacionit dhe, më saktë, projektligjit kur këto ndryshime kanë hyrë në fuqi në 2020-n, ky projektligj dhe ndalimi i përdorimeve publike ka ardhur edhe si një kërkesë e vetë forcave politike për të respektuar disa standarde zgjedhore dhe për të vendosur dhe parandaluar në të njëjtën kohë përdorimin e burimeve publike. Po t'i referohemi kështu edhe marrëveshjes së 5 qershorit, e cila merret si bazë për hartimin e projektligjit të vitit 2020, i cili më pas është miratuar dhe është përfshirë në Kodin Zgjedhor, një nga masat shtesë që duhej të përfshihej në Kodin Zgjedhor dhe që është përfshirë, sipas relacionit, është edhe parandalimi qoftë i blerjes së votës, presioni ndaj votuesve dhe administratës dhe keqpërdorimi i administratës. Në të njëjtën kohë, po t'u referohemi, gjithashtu, raporteve të OSBE-ODIHR-it, që vlejné, po i referohemi kryesisht raportit të vitit 2019, duke qenë se kanë qenë zgjedhjet më të afërta lokale, në të njëjtin raport përfundimtar OSBE-ODIHR-i për këto zgjedhje është shprehur se autoritetet dhe partitë duhen të ndërmarrin masa maksimale për eliminimin e problemit të hershëm, shpërdorimit të burimeve administrative në zgjedhje dhe në periudha midis zgjedhjeve. Prandaj dhe vetë OSBE-ODIHR-- një organizëm i mirënjohur në fushën e zgjedhjeve dhe që ka ekspertizë, për sa i takon fushës së zgjedhjeve dhe mbi bazën e të cilit dhe ekspertimin e së cilit janë miratuar edhe ndryshimet në Kodin Zgjedhor, e ka bërë të qartë që përdorimi i burimeve publike duhet të ndalohet si në zgjedhjet lokale, si në zgjedhjet e përgjithshme, sepse standardi i zgjedhjeve është i njëjtë, zgjedhjet duhet të jenë demokratike, të lira dhe votuesit nuk duhet të jenë pjesë e presionit apo e trysnisë që bëhen në mënyra të ndryshme. Nëse do të ecim me një interpretim të kundërt, do të pranohet, fatkeqësisht, një blerje vote masive nga ana e Këshillit të

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Ministrave, që kamuflohet përmes një akti normativ të Këshillit të Ministrave, duke i lënë hapësirën këtu një subjekti të caktuar politik, që ka edhe pushtetin politik dhe ushtron edhe pushtetin ekzekutiv, në të njëjtën kohë, për të blerë votuesit në një mënyrë masive dhe për të mos e parandaluar dot fenomenin e blerjes së votave. Po t'i referohemi kështu edhe nëse do të kemi pretendime nga Këshilli i Ministrave, ose më saktë do të doja një pyetje përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave. Nëse është e udhës mund ta bëj tani?

Z. I. Celibashi: Mendoj që të dëgjojmë edhe shpjegimet, se ndoshta mund ta marrësh përgjigjen e pyetjes me shpjegimet.

Z. H. Jonuzaj: Dakord, faleminderit! Për sa thashë, duke i qëndruar edhe Kodit Zgjedhor, Kushtetutës dhe frymës së ligjit, shpresoj që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve do të marrë një vendim, i cili do të ndalojë përdorimin e burimeve publike dhe do të krijojë një precedent shumë të mirë për zbatimin e ligjit, por edhe për integritetin e zgjedhjeve.

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave, fjala për ju.

Z. H. Jonuzaj: Faleminderit, i nderuar! Për sa i përket vendimit nr. 187, datë 31 mars 2023 të Këshillit të Ministrave, për shpërblimin e pensionistëve, themi se ky është një akt që është në përputhje të plotë me nenin 91 të Kodit Zgjedhor, gjithashtu, edhe me vendimin nr. 9 të Komisionit Rregullator. Për sa i përket pikës 4, të nenit 91, sikurse e citoi edhe denoncuesi, 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re, pra, në Kodin Zgjedhor gjendet një ndarje e qartë zgjedhjeve të përgjithshme dhe e zgjedhjeve vendore, ndërkohë që pika 4 e Kodit

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Zgjedhor përcakton vetëm formimin e qeverisë së re, pra që nënkupton zgjedhjet e përgjithshme. Për sa i përket pikës 3, që është një riprodhim pothuajse i njëjtë i pikës 4, të nenit 91, që gjendet në vendimin e Komisionit Rregullator, është e njëjta dispozitë. Për të qenë më korrekt, Këshilli i Ministrave, nëpërmjet sekretarit të Përgjithshëm, me shkresën nr. 169/2 të protokollit, datë 23 janar 2023, i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të parë nëse janë të aplikueshëm për zgjedhjet e përgjithshme pika 4 e nenit 91 dhe pika 3 e nenit 3 të vendimit numër 9 të Komisionit Rregullator, dhe nga përgjigjja e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, me shkresën 138/3 datë 28.01.2023, drejtuar sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave sqarohet se nuk ndalohen veprimtaritë e parashikuara në pikën 4 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, nuk ndalohen veprimtaritë e parashikuara në nenin 3 pika 3 dhe 5 të vendimit rregullator nr.9 datë 24.12.2020. Përveç kësaj, edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si institucion që iniciues dhe propozues i projektvendimit për dhënien e shpërblimit për pensionistët, me shkresën nr. 5857, datë 29.3.2023, i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të marrë mendimin e tyre nëse ky projektvendim bie në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe me vendimin e Komisionit Rregullator. Gjithashtu, edhe në kthimin e përgjigjes të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve konfirmohet se kjo veprimtari nuk është e ndaluar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Faleminderit!

Z. Dh. Zguro: Pyetja ime për përfaqësuesin e Këshillit të Ministrave është cili është qëllimi i miratimit të një akti të tillë gjatë periudhës 4-mujore të zgjedhjeve. Cilat janë rrethanat, nëse ka në relacion ndoshta Ministria e Financave në dijëni tuaj një arsyetim për shkaqet e miratimit të një vendimi të tillë?

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Z. H. Jonuzaj: Në relacion janë dhënë shpjegimet përkatëse nga Ministria e Financave. Në relacion thuhet se ka për qëllim përmirësimin e nivelit të plotësimit të nevojave të pensionistëve. Ë njëjta gjë është bërë edhe në dhjetor të vitit 2022, pikërisht për të plotësuar nevojat e pensionistëve edhe si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në Shqipëri nga lufta në Ukrainë, pra rritja e çmimeve, rritja e produkteve dhe për këtë arsye Këshilli i Ministrave, nëpërmjet dhënies së këtij shpërblimi, ka parë mundësinë për t'u ardhur në ndihmë pensionistëve. Pra, është një masë që është marrë edhe në dhjetor edhe në prill dhe do të vazhdojë.

Z. Dh. Zguro: Fakti që, për mendimin tim, edhe Këshilli i Ministrave pranoi diçka që ky vendim është miratuar si pasojë e rrethanave dhe për t'u ardhur në ndihmë pensionistëve, mendoj se duhet të konsiderohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve si një fakt ndoshta edhe më rëndues për sa i takon shkeljes që ka ndodhur, sepse po t'i referohemi vetë Institutit të Statistikave dhe është një provë që është depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, muaji mars 2023 është muaji me inflacionin më të ulët, sipas Institutit të Statistikave, me 5.2%, ndërkohë që në prill 2022 ka qenë 6.2%. Kur inflacioni ka qenë 8% në gusht, Këshilli i ministrave nuk ka marrë asnjë vendim të tillë, kur inflacioni ka qenë 8.3% në muajin tetor 2022 Këshilli i Ministrave sërish nuk ka marrë një vendim të tillë. Kur inflacioni ka qenë 7.9, 7.5% sërish Këshilli i Ministrave nuk ka marrë asnjë lloj vendimi për t'iu ardhur në ndihmë pensionistëve, por ndërkohë pensionistëve iu vihet në ndihmë vetëm në periudhën e zgjedhjeve kur inflacioni është më i ulët, është në pikën vet më të ulët, është 5.3% dhe kjo nuk është një statistikë që e thotë Qëndresa Qytetare, por është një statistikë e nxjerrë nga Instituti i Statistikave, që provon edhe një herë atë të cilën ne e kemi denoncuar, përdorimin e frikshëm të burimeve publike, me qëllim kamuflimin e blerjes së votës. Edhe në referim të

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

nenit 91, pika 4, i cili duhet të interpretohet në mënyrë të zgjeruar, standardet demokratike të zgjedhjeve janë të njëjta, qoftë për zgjedhjet e përgjithshme, qoftë për zgjedhjet vendore. Nuk mund të pranohet përdorimi i burimeve publike për zgjedhjet e përgjithshme dhe të mos pranohet për zgjedhjet lokale. Nëse përdorimi i burimeve publike bëhet qoftë për zgjedhjet lokale, qoftë për zgjedhjet e përgjithshme, kjo nuk ka asnjë lloj rëndësie për aq kohë sa përbën shkelje. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i koalicionit Bashkë Fitojmë.

Z. F. Nuri, përfaqësues i BF: Faleminderit, zoti Celibashi! Desha të ndërhyj si palë e interesuar në këtë debat, sepse dhe ne si koalicion apo si opozitë kemi mbajtur qëndrim në lidhje me këto çështje. Qëndrimi ynë publik shkon në vijimësi të denoncimit të Qëndresës Qytetare dhe dua t'i falënderoj për angazhimin që kanë dhe që e kanë sjellë në rendin e ditës këtë çështje sot, sepse realisht kemi vënë re një përdorim masiv të administratës publike, të fondeve publike, të parave publike në këtë fushatë zgjedhore. Në këtë rast neni 91 i Kodit Zgjedhor, në gjykimin tonë, është mjaft i qartë. Nuk mundet që ajo e dispozitë e veçantë, në mos gaboj, pika 4 e nenit nuk mund të interpretohet, në vlerësimin tonë, e veçuar nga i gjithë konteksti jo vetëm i nenit, por i gjithë kapitullit, ku neni 91 është te Kodi Zgjedhor, që flet për rregullat dhe ndalesat në zgjedhje, pa barë dallime midis zgjedhjeve lokale apo zgjedhjeve të përgjithshme. Një dispozitë e tillë, që mund të ketë njëfarë inbiguiteti, ndoshta sepse flet për deri në katër muaj përpara dhe deri në informonin e institucionit, të ekzekutivit të qeverisë, siç është formulimi, nuk mund të interpretohet, në gjykimin tonë, si një dispozitë e veçuar dhe të arrihet në konkluzionin se ligjvënësi paska dashur të bëjë një përjashtim nga rregulli. Cili do

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

të ishte përjashtimi, në qoftë se do ta bëjmë me interpretim atkontrario? Përjashtimi nga rregulli do të ishte që ligjvënësi ka lejuar që të përdoren fonde publike dhe administrata publike masivisht në zgjedhjet lokale, kurse për qeverisjen qendrore kjo gjë u ndaloka. Nuk besoj se ky do të jetë interpretimi që do të bëjnë OSBE-ODIHR-i në lidhje me këto shkelje dhe denoncime, që ne edhe si opozitë i kemi bërë. Shpresoj që edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të mbajë këtë qëndrim, t'i qëndrojë strikt Kodit Zgjedhor dhe të ndalojë këto lloj praktikash, të cilat në konkluzion, dua ta shpreh, që edhe vetë pensionistët e kanë mjaft të qartë se për çfarë arsyeje janë bërë, pak javë apo pak ditë para zgjedhjeve. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po, përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave.

Z. H. Jonuzaj: Sikurse e thashë kjo ishte një masë që u mor edhe në dhjetor të vitit 2022, pra ishte edhe përtej afatit 4-mujor, pra nuk ka asnjë lidhje me pjesën e zgjedhjeve, u mor edhe tani. Kjo nuk është se sa herë që rritet inflacioni apo si janë statistikatat, por sa herë ka mundësi buxheti i shtetit për të përballuar një dhënie shpërblimi për pensionistët. Efektet financiare, sikurse i lexoi edhe denoncuesi, janë të konsiderueshme dhe kjo bëhet sa herë që ka mundësi buxheti i shtetit. Pra, në muajin dhjetor nuk ishim as në afatin 4 muaj përpara zgjedhjeve dhe përsëri u bë nga Këshilli i Ministrave. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Një pyetje kam, të lutem: paratë për këtë shtesë nga vijnë?

Z. H. Jonuzaj: Paratë janë të parashikuara te ligji për buxhetin e shtetit, te fondi i kontigjencës.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Z. I. Celibashi: Po, kur është miratuar ky ligj?

Z. H. Jonuzaj: Ligji është miratuar në dhjetor të vitit paraardhës 2022-shit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Kemi pyetje të tjera?

Z. H. Jonuzaj: Jo asnjë pyetje.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Vendosim për këtë çështje në vijim dhe besoj ndoshta në seancën e ditës së premte do të bëjmë publike dhe vendimin në lidhje me këtë denoncim. Ndërkohë do të administrojmë një relacion të Ministrisë së Financave në lidhje me këtë projektvendim, besoj që nëqoftëse nuk e kemi do të na vij në dispozicion nga Këshilli i Ministrave.

*Zbardhi materialin audio
Eneida STEFA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

03.05.2023
Ora 13:18

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (vijon emri i subjektit zgjedhor)”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Znj. V. Ballgjini, I. Osmani, P. Doci**
- **Parti Politike:** **BF**
- **OJQ:** **KRIIK, OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës, kemi projektvendimin për heqjen e materialeve propagandistike të cilat nuk përmbajnë shënimin mbi prodhuesin dhe përgjegjësinë ligjore të atij që e ka vendosur materialin propagandistik, po.

Z. V. Ballgjini: Organizata Koalicioni për Reformë dhe Integrim dhe institucione të konsoliduara KRIIK ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datë 18 prill 2023 një sinjalizim mbi afishimin publik të materialeve propagandistike zgjedhore, të subjektit zgjedhor Partia Socilaiste e Shqipërisë, i cili nuk është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Nga verifikimet e monitoruesëve asnjë prej posterave të publikuar nga subjektet zgjedhore, nuk respektonin parshikimin e

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

pikës 3, të nenit 79, të Kodit Zgjedhor i cili përcakton se të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhen të shoqërohen me shënimin ‘prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të’ dhe më pas të vijojë me emrin e subjektit zgjedhor i cili e afishon. Për këtë arsye Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin me numër 414 datë 25 prill 2023, për vendosjen nga subjektet zgjedhore të shënimit përkatës identifikues të materialeve propagandistike iu lë afat të gjitha subjekteve zgjedhore që brenda datës 28 prill 2023, të vendosin në materialet propagandistike të afishuara prej tyre shënimin ‘prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të’ dhe më pas të vazhdojë emri i subjektit. Nga verifikimi dhe në vlerësim të dokumentacionit që kemi administruar prej monitoruesëve të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve rezulton se jo të gjitha materialet propagandistike të afishuara e përmbajnë këtë shënim. Përsa më sipër ju paraqitet projektvendimi për shqyrtim.

Z. I. Celibashi: Përfaqësues të koalicionit? Mirë atëhere ne do të urdhërojmë që të hiqen të gjitha materialet propagandistike të kujtdo subjekti zgjedhor, të cilat nuk përmbajnë shënimin ‘prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të’ dhe emrin e subjektit dhe do të urdhërohen Policinë Bashkiake dhe Policia e Shtetit për t’i hequr këto materiale menjëherë. Kjo vlen për të 61 bashkitë dhe vlen për të gjitha subjektet, dhe deri në orën 24.00 të ditës së premte të kësaj jave do të duhet që të marrim një informacion nga drejtuesit respektiv të Policive Bashkiake dhe të Policisë së Shtetit në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

Vendimi nr. 424

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

03.05.2023
Ora 13:21

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore deri më date 2 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Znj. V. Ballgjini, I. Osmani, P. Doci**
- **Parti Politike:** **BF**
- **OJQ:** **KRIIK, OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër që ka të bëjë me vlerësimin e raporteve të monitoruesëve të fushatës zgjedhore, për periudhën deri në datën 2 maj, po.

Z. V. Ballgjini: Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve deri në datën 2 maj 2023 janë administruar raportet e monitorimit lidhur me shkeljet e konstatuara për 12 Zyra Zgjedhore dhe 6 materiale propagandistike, 12 raporte monitorimi për Zyra Zgjedhore të hapura në kundërshtim të pikës 1, të nenit 5, të udhëzimit numër 6 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të cilat janë hapur në një distancë më të vogël se 300 metra nga vendndodhja e KZAZ-ve dhe QV-ve dhe VNV-ve. Për Bashkinë Tiranë, janë administruar 6 raporte monitorimi, në datën 4 prill 2023 është administruar raporti i monitorimit ku konstatohet një Zyrë Zgjedhore hapur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, në adresën rruga Kongresi i Lushnjes përballë kopshtit 26. I është dërguar email subjektit zgjedhor për mbylljen

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

e kësaj zyre dhe nga verifikimi i monitoruesit kjo zyrë rezulton e mbyllur. Në datë 13 prill 2023 është administruar raporti i monitorimit ku konstatohet një zyrë zgjedhore e Koalicionit Bashkë Fitojmë me vendndodhje në adresën rruga Artan Llenja 150 metra nga shkolla Gustav Major dhe 170 metra nga shkolla Naim Frashëri. I është dërguar email subjektit për mbylljen e zyrave dhe nga verifikimet e monitoruesit rezulton se zyra vazhdon të jetë ende e hapur. Në datë 18 prill 2023 është administruar raporti i monitorimit ku konstaton një zyrë zgjedhore e Koalicionit Bashkë Fitojmë në adresën rruga Margarita Tutulani 110 metra nga shkolla Dëshmorët e Lirisë, nga verifikimet e tyre rezulton të jetë e mbyllur dhe pse ka logo të subjektit. Në datë 23 prill 2023 është administruar raporti i monitorimit ku konstaton një zyrë zgjedhore zgjedhore për subjektin zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, në bulevardin Petro Nini Luarasi, 30 metra nga Qendra e Votimit shkolla e Baletit, pasi iu dërgua email subjektit zgjedhor për mbylljen e zyrës, është kthyer përgjigje nga përfaqësues ligjor i Partisë Demokratike të Shqipërisë i cili sqaron se zyra është seli qendrore e partisë, pra nuk është zyrë elektorale. Është administruar raporti i datës 28 prill 2023 nga monitoruesi i cili konstaton një zyrë zgjedhore të subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, në adresën rruga Nasip Pavllo 180 metra nga Liceu Jordan Misja. Pasi ju dërgua email subjektit zgjedhor për mbylljen e zyrës është kthyer përgjigje nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Shqipërisë i cili sqaron se nuk është zyrë e hapur nga Partia Demokratike e Shqipërisë edhe pse ka logo të kësaj partie. Për Bashkinë Durrës është administruar një raport në datën 26 prill 2023 monitoruesi raporton për subjektin është hapur një zyrë zgjedhore nga subjekti Partia Socialiste e Shqipërisë, në njësinë Shkozet, Durrës, 80 metra nga Qendra e Votimit shkolla Beqir Çela. I është dërguar email subjektit për mbylljen e zyrës dhe jemi akoma në proces verifikimi. Për Bashkinë Elbasan është administruar një raport monitorimi në datë 24 prill 2023 për

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

hapjen e një zyre të Koalicionit Bashkë Fitojmë e cila ndodhet në një distancë prej 50 metrash nga Qendra e Votimit universiteti Aleksandër Xhuvani, jemi akoma në proces verifikimi. Për Bashkinë kavajë është administruar një raport nga monitoruesi për këtë bashki në datë 14 prill 2023. Raporti i monitorimit thekson se është një zyrë e hapur nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë e cila ndodhet afër Qendrës së Votimit në Pallatin e Kulturës, vazhdojmë të jemi ende në proces të verifikimit të kësaj zyre. Për Bashkinë Kukës janë administruar 2 raporte në datë 26 prill 2023, raporti i monitoruesit në lidhje me çeljen e zyrës së subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë afër Qendrës së Votimit shkolla Bajram Curri, dhe në datë 26.04.2023 vjen sërish një raport lidhur me hapjen e një zyre nga Koalicioni Bashkë Ftojmë afër Qendrës së Votimit shkolla Bajram Curri. Jemi në proces të verifikimit për të dyja subjektet zgjedhore për çeljen e këtyre zyrave. Dhe për Bashkinë Fier është administruar një raport monitorimi, ku konstatohet një zyrë zgjedhore e subjektit zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë, afër Qendrës së Votimit shkolla Janaq Kilica, i është dërguar një email subjektit zgjedhor për mbylljen e zyrës dhe nga verifikimet e bëra rezulton që kjo zyrë është e mbyllur. Gjithashtu janë administruar 6 materiale monitorimi mbi vendosjen e materialeve propagandistike, në kundërshtim të pikës 2, të nenit 3, të udhëzimit të numër 6, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve mbi ndalimin e afishimit të materialeve propagandistike në fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo amienteve rrethuese pranë tyre, brënda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit. Për Bashkinë Tiranë janë administruar tre raporte të monitoruesëve, në datën 20 prill 2023 është administruar raporti i monitorimit ku konstatohet vendosja e materialeve propagandistike në fasadë banimi, nga subjekti zgjedhor Aleanca Progresiste LZHK, në rrugën Fatos Baxhaku. Nga verifikimet e bëra nga monitoruesi materiali i vendosur është 8 metra larg zyrës së partisë politike.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Në datë 26 prill 2023 është administruar raporti i monitorimit ku konstatohet vendosja e materialeve propagandistike në shtylla ndriçimi, nga Koalicioni Bashkë Fitojmë, në rrugën Veli Dedi, nga verifikimet rezulton se në një të shtyllë janë hequr dhe në tjetrën vazhdojnë të mbeten aty. Për Bashkinë Durrës janë administruar tre raporte monitorimi, respektivisht në datën 25 prill 2023, raporti i monitorimit ku konstatohet vendosja e materialeve propagandistike në fasadën e qendrës tregëtare Flagship në Durrës, nga Koalicioni Bashkë Fitojmë, jemi në proces të verifikimit të këtij raporti. Në datën 27 prill 2023 është administruar raporti i monitorimit ku konstatohet një billboard i subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, në afërsi të Qendrës së Votimit Pallati i Sportit Ramazan Ngjala, Durrës. I është dërguar email subjektit për heqjen e materialit, vazhdojmë të mbetemi në proces të verifikimit të këtij raporti. Në datë 27 prill 2023 është administruar raporti i monitorimit ku konstatohen flamuj të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, në fasadë banimi, në vendndodhjen përballë shkollës së mesme profesionale Beqir Çela në Shkozë, u është dërguar email subjektit zgjedhor për heqjen e materialit, akoma jemi në proces të verifikimit nga monitoruesi. Gjithashtu doja të sillja në vëmendje që në datë 25 prill 2023, referuar një afati në seancën publike, iu la një afat kryetarëve të bashkive lidhur me përcaktimin e vendeve të lejuara për afishimin e materialeve propagandistike. Deri më tani kakthyer përgjigje dhe ka sjellë vendimet e tyre Bashkia Këlcyre, Bashkia Poliçan, Bashkia Durrës, Maliq, Elbasan, Gramsh, Tepelenë, Fier, Berat, Përmet, Mat, Përrenjas, Sarandë, Belsh dhe Tropojë dhe Dimal e kanë sjellë tani, bashkitë e tjera nuk kanë sjellë ende përgjigje lidhur me afishimin e materialeve propagandistike dhe vendet e lejuara. Çështje të mbartura, kemi çështjen e mbartur lidhur me denoncimin numër 387 ID, datë 18.04.2023, të Partisë Socialiste të Shqipërisë ndaj subjektit zgjedhor Koalicioni Bashkë Fitojmë në Bashkinë Kavajë, për vendosjen e materialit propagandistik në kundërshtim me

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

udhëzimin numër 6, datë 21.03 2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për verifikimin e këtij materiali u caktua monitoruesi përgjegjës për Bashkinë Kavajë, pas verifikimit u administrua raporti monitorimit në datë 19 prill me anë të së cilit u vërtetua prania e materialit propagandistik, në fasadën e institucionit publik Posta Shqipëtare. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve datë 19.04. 2023 njoftoi subjektin zgjedhor për heqjen e materialit propagandistik, pasi bie në kundërshtim me përcaktimet e udhëzimit me numër 6. Pas njoftimit që ju dërgua subjektit zgjedhor nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, u ricaktua dhe një herë monitoruesi për të verifikuar nëse materiali propagandistik është hequr apo jo. Në datë 24 prill 2023 u administrua raporti i monitoruesit ku konstaton se materiali propagandistik i subjektit Bashkë Fitojmë, nuk është hequr ende. Gjithashtu kemi edhe një çështje të mbartur nga organizata KRIIK, denoncim me numër 386 ID, të datës 25 prill 2023. Monitoruesit e KRIIK kanë evidentuar një numër billboard-ash në afërsi të aksit kombëtar në juridiksionin e bashkive të ndryshme, nga monitorimi i bërë nga KRIIK në teritorin e disa bashkive, ku bëhet fjalë për aksin kombëtar Tiranë-Lushnje, më saktë për Bashkitë Lushnje, Rogozhinë, Kavajë dhe Durrës, janë afishuar në kundërshtim me

Z. I. Celibashi: Këtë nuk e kemi në rend dite sot, e kemi në rend dite?

Z. V. Ballgjini: Jo thjesht është çështje që thamë do e risjellim dhe një herë në..

Z. I. Celibashi: Dakord, duhet të ishte në rend dite, duhet ta kishim futur formalisht në rend dite, por gjithsesi vazhdojmë

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

**03.05.2023
Ora, 13:31**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 387, të Partisë Socialiste të Shqipërisë ndaj subjektit zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për vendosje materiali propagandistik në Bashkinë Kavajë”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafi KQZ: **Znj.P. Doçaj, Znj. M. Koja,
Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **BF (Z. Franci Nuri)**
- **Të tjerë:** **KRIK, OSBE/ODIHR,**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë.

Znj. V. Ballgjini: Kemi çështjen e mbartur lidhur me denoncimin nr. 387 ID, datë 18.04.2023 të Partisë Socialiste të Shqipërisë ndaj subjektit zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë” në Bashkinë Kavajë, për vendosjen e materialit propagandistik, në kundërshtim me vendimin nr. 6, dt. 21.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Për verifikimin e këtij materiali u caktua monitoruesi përgjegjës për Bashkinë Kavajë. Pas verifikimit u administrua raporti i monitorimit në datën 19 prill, me anë të së cilit u vërtetua prania e materialit propagandistik në fasadën e institucionit publik Posta Shqiptare. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në datën 09.04.2023 njoftoi subjektin zgjedhor për heqjen e materialit propagandistik pasi

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

bie në kundërshtim me përcaktimet e udhëzimit nr. 6. Pas njoftimit që ju dërgua subjektit zgjedhor nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u ricaktua edhe njëherë monitoruesi për të verifikuar nëse materiali propagandistik është hequr apo jo. Në datën 24 prill 2023 u administrua raporti i monitoruesit, ku konstaton se materiali propagandistik i subjektit “Bashkë Fitojmë” nuk është hequr ende.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda Bahollari*



RENDI I DITËS

Shqyrtimi i denoncimit me nr. 386 ID të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për vendosje materiali propogandistik në Bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Lushnje, Durrës.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:** Z. Ilirjan Celibashi
- **Stafi KQZ:** Z. Y.Merkaj, Znj. M. Koja,
Znj. I. Osmanaj, Znj. P. Doçaj,
Znj. V. Ballgjini,
- **Parti Politike:** Bashkë Fitojmë (F.Nuri)
- **Të tjerë:** KRIIK, OSBE ODIHR,

Z. I. Celibashi: Mirë, vazhdojmë!

Znj. V. Ballgjini: Më datë 24 Prill 2023 u administrua raporti i monitoruesit, ku konstaton se materiali propogandistik i subjektit Bashkë Fitojmë, nuk është hequr ende. Gjithashtu kemi edhe një çështje të mbartur nga organizata KRIIK, denoncim me numër 386 ID të datës 25 prill 2023. Monitoruesit e KRIIK kanë evidentuar një numër billboarderash në afërsi të aksit kombëtar, në juridiksionin e bashkive të ndryshme nga monitorimi i bërë nga KRIIK në territorin e disa bashkive, ku bëhet fjalë për aksin kombëtar Tiranë-Lushnje. Më saktë për bashkitë Lushnje, Rrogozhinë, Kavajë dhe Durrës, janë afishuar në kundërshtim me...

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Z. I. Celibashi: Këtë nuk e kemi sot në rend dite.

Znj. V. Ballgjini: Jo, thjesht është çështje që tham do e risjellim edhe njëherë...

Z. I. Celibashi: Dakord, por duhet të ishte në rend dite, duhet ta kishin vendosur fomalisht në rend dite por gjithsesi, vazhdojmë.

Znj. V. Ballgjini: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve caktoi monitoruesit sipas zonave përkatëse, për verifikimin e këtyre materialeve dhe nga raportet e dorëzuara nga monitoruesit vërtetohet prania e billboarderave në akset rrugore Tiranë-Lushnje. Pra vazhdojnë, janë...

Z. I. Celibashi: Mirë! Deri ditën e premte do të bëjmë një komunikim me të gjithë subjektet të cilat kanë problematika në vlerësimin tuaj. Problematika në lidhje me vendosjen e materialeve propagandistike dhe ditën e premte do të shpallim vendimin për secilin prej këtyre rasteve. Dakord? Për të gjitha denoncimet dhe të gjitha çështjet që kemi patur do të shprehemi me vendim përfundimtar, ditën e premte. Kështu që do të jenë në rendin e ditës të mbledhjes së ditës premte.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e raportit të autoritetit të medias audiovizive të pasqyrimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 14-22 prill 2023”.

PJESËMARRJA :

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan Celibashi**
- Stafi KQZ: **Znj. M. Koja, Znj. V. Ballgjini
Znj. I. Osmanaj, Znj. P. Doçaj**
- Parti Politike: **Bashkë Fitojmë (F.Nuri)**
- Të tjerë: **KRIIK, OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Mirë, vazhdojmë!

Znj. V. Ballgjini: Çështja e fundit e mbartur është raporti i autoritetit të mediave audiovizive për periudhën 14-22 prill 2023.

Z. I. Celibashi: Po.

Znj. V. Ballgjini: Neni 79, i ligjit 119, datë 29.12.2008 i Kodit Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, parashikon të drejtat dhe detyrimet e subjekteve zgjedhore gjatë fushatës zgjedhore. Nenet 80 dhe 81 të Kodit Zgjedhor parashikojnë rregullat e pasqyrimit të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore dhe edicionet infomative në radiotelevizionin publik. Neni 83 i Kodit Zgjedhor përcakton se këshilli drejtues i radiotelevizionit publik jo më vonë se 30 ditë para

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023**

datës së zgjedhjeve, cakton minutazh në dispozicion të çdo partie, në bazë të të dhënave të paraqitura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për partitë e regjistruara. Gjithashtu ky këshill cakton nën mbikqyrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shortin për vendosjen e segmenteve orare për çdo parti të regjistruar. Nëni 84 i Kodit Zgjedhor përcakton se në fushatat zgjedhore në radiot dhe televizionet publike duhet të përcaktohen qartë rregullat e pasqyrimin të fushatave zgjedhore, minutazhi politik, transmetimi i veprimtarive të institucioneve publike qendrore apo vendore, pasqyrimi i veprimtarisë së partive joparlamentare, marrëdhënien me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe kompetencat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të urdhëruar entin rregullator për të proceduar me bllokimin e transmetimeve në rastet e konstatimit të shkeljeve. Neni 85 i Kodit Zgjedhor shprehet mbi monitorimin e fushatës zgjedhore në media i cili kryhet nga enti rregullator dhe në këtë rast është Autoriteti i Medias Audiovizive të cilat në zbatim të paragrafit të katërt kanë detyrimin të pasqyrojnë gjetjet e veta nga procesi i monitorimit në raporte të detajuara dhe t’ja paraqesin Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për kompetencë. Raportet shoqërohen sipas rastit me propozime për masa konkrete administrative. Në raportin e parë përmbledhës të dorëzuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vendimi numër 26 datë 25 prill 2023 i Autoritetit të Medias Audiovizive (për shqyrtimin e raportit të medias Audiovizive të pasqyrimin të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhen 14-22 prill 2023) vërejmë jo vetëm treguesit e monitoruar por edhe propozimet përkatëse për marrjen e masave administrative. Raporti përmbledhës përmban të dhëna mbi depozitimin AMA të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të, kohën e monitorimit të OSHMA-ve në monitorim për transmetimin e lajmeve, hapësirën për çdo aktor politik, kohën e monitorimit të OSHMA-ve për transmetimet e emisioneve, reklamat politike si dhe raporti gjinor të mbulimit

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

mediatik të kandidatëve. Në lidhje me treguesin depozitimi i regjistrimeve në AMA në pikën 6 të nenit 85 të Kodit Zgjedhor, përcaktohet se radiot dhe televizionet publike dhe private janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha transmetimet e tyre përgjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore. Këto regjistrime ruhen deri në mbarimin e dhjetë muajve nga data e zgjedhjeve dhe vihen me kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve menjëherë në dispozicion të saj. Detyrimin për depozitimin e transmetimeve të çdo dite parashikohet në metodologjinë e monitorimit të medias audiovizive, sipas OSHMA-ve vendore që mbulohen nga mjetet monitoruese janë të detyruara të depozitojnë pranë AMA-s përmbajtjen e transmetuar në fillim të çdo dite pasardhëse monitoruese. Në zbatim të vendimit numër 26 datë 25.04.2023 të AMA-s rezultojnë se katër subjekte audiovizive nuk kanë respektuar detyrimin ligjor të sipërcituar pasi nuk kanë dorëzuar regjistrime për asnjë nga ditët e kësaj periudhe të monitoruar 14-22 prill. AMA i ka propozuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për këto OSHMA tw procedohet me marrje mase administrative sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu referuar këtij propozimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar një email nga një adresë tvklaudiana@yahoo.it në të cilën informojnë se nga muaji shkurt 2023 aksionet e këtij televizioni kanë kaluar në pronësi të kompanisë Tibo. AMA ka kthyer një përgjigje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ku nëpërmjet vendimit të AMA-s numër 135 datë 15 dhjetor 2022 është miratuar kalimi i të drejtave që burojnë nga licenca e subjektit person fizik Alesia Vogli për shërbimin e programit audioviziv Tv Klaudiana tek shoqëria Tibo. Për shkak të vijimit të ruajtjes së emrit tregëtar të subjektit audioviziv në fjalë panvarësisht ndryshimit në strukturë pronësore kërkesa e AMA-s për depozitim të regjistrimeve është dërguar në adresën elektronike dhe postare të mëparshme të Tv Klaudianës. Megjithatë nga momenti që janë njoftuar lidhur me

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

këtë ndryshim edhe nga ana e KQZ-së do të vazhdojnë ti kërkojnë kompanisë së re regjistrimet për këtë periudhë kohore. Gjithashtu AMA informon se katër ofrues të shërbimeve mediatike dhe/ose audiovizive kanë depozituar regjistrime për jo të gjitha ditët e kësaj periudhe. AMA i propozon KQZ-së tu tërheq vëmendje OSHMA-ve për respektimin e plotë të këtij detyrimi. Lidhur me treguesin reklama politike, në pikën 7 të nenit 84 të Kodit Zgjedhor përcaktohet se reklamato politike të subjekteve zgjedhore transmetohen ndërmjet intervaleve kohore nga ora 15:00 – 18:00 dhe nga ora 21:00 – 24:00 të programit ditor. Referuar vendimit numër 26 datë 25.04.2023 të AMA-s rezulton se tre subjekte audiovizive nuk kanë respektuar detyrimin ligjor të sipër cituar pasi kanë transmetuar reklama jashtë fashave orare të lejuara. Nga verifikimi i raporteve ditore të dorëzuara nga AMA në KQZ rezulton se njëri nga këto tre subjekte i ka transmetuar reklamato brenda fashës orare të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor. AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve tu kërkojë OSHMA-ve ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike në kohën e ndaluar nga Kodi Zgjedhor. Sa i takon vlerësimin gjinor AMA i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t'i tërheqë vëmendje OSHMA-ve për të rritur nivelin e ndjeshmërisë ndaj kriterit të përfaqësimit gjinor në fushatën zgjedhore. Pas verifikimeve përkatëse të dokumentacionit në tërësi në lidhje me shqyrtimin e raportit të medias audiovizive të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 14 prill 2023 deri më 22 prill 2023 konstatohet se dokumentacioni i paraqitur nga AMA është i plotë. Në mbështetje të neneve të sipër cituara dhe të nenit 19 të Kodit Zgjedhor propozojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve miratimin e masave. Bashkëlidhur vendimi.

Z. I. Celibashi: Dakord. Operatorëve radioteleviziv, televiziv më mirë të themi që nuk kanë bërë depozitimin e materialeve (ishin 3 nëse nuk gabo) edhe sipas

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt. 03.05.2023*

rekomandimit të AMA-s do ti tërhiqet vëmendje, mbi detyrimin që kanë për të depozituar këto materiale dhe ti urdhërojmë ti depozitojnë. Jo vetëm nga ky moment që ky vendim do të hyjë në fuqi por edhe më herët duke shpresuar se i kanë ato materiale, i kanë ruajtur të paktën për qëllimet e tyre.

Znj. F. Nuri: Një ndërhyrje i nderuar sepse nuk desha të ndërpres relatoren. Në lidhje me bashkitë të cilët nuk kanë përcaktuar ent dhe nuk kanë marrë vendim ende për vendet fizike të vendosjen së posterave apo të materialeve propagandistike, çfarë vendimmarrje do të marrë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për ato bashki? Mos gaboj ishte Bashkia Tiranë si dhe disa Bashki si Durrësi, Elbasan dhe disa të tjerë kishin raportuar. Cili është vendimi që do të marrë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në lidhje me nxitjen që ky urdhër të zbatohet dhe të jetë efektiv? Faleminderit.

Z. I. Celibashi: Ne do marrim masa administrative, do të verifikojmë listën përfundimtare të bashkive që nuk e kanë sjell këtë informacion dhe natyrisht që do të ketë sanksione administrative. Për tu kthyer tek çështja e raportit të monitorimit të mediave nga AMA kishim dy gjetje: një në lidhje me mosdorëzimin dhe tjetra lidhje me fashën orare të transmetimit të reklamave. Gjithashtu edhe për këtë do të urdhërojmë të ndalojnë ato televizione. Ishin media lokale nëse nuk gaboj? Po! Do të urdhërojmë këto media që të ndërpresin transmetimin e reklamave politike jashtë fashave orare që ka përcaktuar ligji. Dakord?!
Tjetër nuk kemi!

Znj. V. Ballgjini: Edhe respektimi i raportit gjinor. Thjesht tërheqje vëmendje.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Z. I. Celibashi: Po, tërheqje vëmendje për respektimin e raporteve gjinore.
Dakord.

Vendim nr. 425

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Divjakë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Fatjon Filip Lena”.

PJESËMARRJA :

- **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: Z. Ilirjan Celibashi**
- **Stafi KQZ:** Znj. V. Ballgjini
Znj. I. Osmanaj, Znj. P. Doçaj
- **Parti Politike:** Bashkë Fitojmë (F.Nuri)
- **Të tjerë:** KRIJK, OSBE ODIHR

Z. I. Celibashi: Kemi edhe dy çështje të fundit lidhur me plotësim vakance për Këshillin e Bashkisë Divjakë dhe dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatin nga lista shumëmërore e Partisë Solialiste të Shqipërisë zotit Frrok Gjin Gjini për qarkun e Shkodrës. Shkurt, ka ndonjë ndalim për të marrë mandatin për të dyja rastet...

Znj. V. Ballgjini: Jo, për të dyja rastet nuk ka asnjë ndalim. Në të dyja rastet ti relatoj apo?...

Z. I. Celibashi: Shkurtimisht!

Znj. V. Ballgjini: Jemi bërë me dije për zëvendësimin e vakancës, për krijimin e vakancës në këshillin e bashkisë Divjakë nga këshilltari zonja Nertila Lazar Kina.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

Në referim të ligjit kandidati vijues nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste për këshillin e bashkisë Divjakë është zoti Fatjon Filip Lena. Nga ana jonë është kërkuar plotësimi i dokumentacionit brenda afatit ligjor. Ky i fundit e ka depozituar brenda afatit ligjor formularin e dekriminalizimit ose të vetëdeklarimit nga i cili nga verifikimi përkatës rezulton që nuk ka të deklaruar asnjë parashikim që është në kushtet e ndalimit përsa i përket ligjit numër 138 të vitit 2015. Në kuadër të detyrimeve që janë bërë nga ligji kemi kryer verifikime të mëtejshme duke kërkuar infomacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Zyra e gjendjes civile nuk na ka kthyer përgjigje ndërsa zyra e gjendjes gjyqësore na ka kthyer përgjigje dhe është konstatuar që kandidati nuk ka vendime penale të formës së prerë. Në këto kushte referuar edhe vendimit të Kuvendit pra numër 17 të vitit 2016 nuk përbën kusht për mosgjetshmërinë në funksionin e kandidatit për këshilltar të këshillit të bashkisë Divjak. Bashkëlidhur edhe projektvendimi.

Z. I. Celibashi: Dakord! Atëhere miratojmë plotësimin e vakancës për këshillin e bashkisë Divjakë me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë zotin Fatjon Filip Lena.

Vendim nr. 430

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kandidati i listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë zoti Frrok Gjin Gjini, Qarku Shkodër”.

PJESËMARRJA :

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve: **Z. Ilirjan Celibashi**
- Stafi KQZ: **Znj. V. Ballgjini**
Znj. I. Osmanaj, Znj. P. Doçaj
- Parti Politike: **Bashkë Fitojmë (F.Nuri)**
- Të tjerë: **KRIIK, OSBE ODIHR**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek çështja tjetër?!

Znj. V. Ballgjini: Po! Edhe në këtë rast jemi njoftuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 27.03.2023 për krijimin e një vakance si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit zotit Benet Bari Beci, i zgjedhur në zonën zgjedhore Qarku Shkodër dhe i përket subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Nga verifikimi i vendimit 410 të datës 23.06.2021 me anë të së cilit Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka përcaktuar mandatet dhe gjithashtu ka verifikuar apo ka përcaktuar rirenditjen e mandateve për ata kandidatë të cilët nuk kanë përfituar mandate. Në kuadër të këtij vendimi dhe në kuadër të nenit 164 rezulton që mandati i kalon ose i përket më saktë deputetit me numër rendor 5 zotit Frrok Gjin Gjini. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga ky i fundit, formularit të vetdeklarimit, ka rezultuar që nuk ka të deklaruar asnjë të dhënë që të jetë në kushtet e ndalimit përse

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.03.05.2023*

i përket ligjit 138 të vitit 2015. Janë kryer verifikimet përkatëse në drejtorinë e gjendjes civile dhe asaj gjyqësore dhe na është kthyer përgjigje vetëm nga gjendja gjyqësore dhe rezulton që nuk ka asnjë vendim penal të formës së prerë në ngarkim të këtij kandidati. Po kështu edhe nga verifikimi i formularit dhe nga këto të dhëna jemi në kushtet kur nuk përbën kusht për mosgjatshmërinë e kandidatit në funksionin e kandidatit për deputet në Republikën e Shqipërisë. Bashkëlidhur dhe projektvendimi për shqyrtim.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë miratojmë dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë zotit Frrok Gjini Gjini për qarkun e Shkodrës. Çështje të tjera në rend dite, nuk kemi. Mirë, faleminderit. Seanca mbyllet.

Vendim nr. 431

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

